

Në bazë të nenit 28 paragrafi (2), nenit 30 paragrafi (1) dhe nenit 45 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në përbërje: Mr. Borçe Razmoski – Kryetar, Mr. Malinka Siljanovska Nikoliq, Aleksandar Trgaçevski, Nikolla Trajçevski dhe Valon Elezi - anëtarë, duke vepruar sipas detyrës zyrtare kundër Shoqërisë për grumbullim dhe përpunim primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup, me seli në rr. "Gjorgji Kolozov" nr. 10, Gazi Babë, e përfaqësuar nga Vllado Momirovski - drejtues, për shkak të konstatimit të kundërvajtjes së kryer nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në seancën e mbajtur më 11.07.2025, solli këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se Shoqëria për grumbullim dhe përpunim primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup, me seli në rr. "Gjorgji Kolozov" nr. 10, Gazi Babë, e përfaqësuar nga Vllado Momirovski - drejtues, me NUAS: 5124514, Numri Unik Tatimor: 4030996203809, xhiro-llogari nr. 2300000000180650 në NLB Banka Komerciale - Shkup, nuk ka vepruar sipas Konkluzionit për dorëzimin e të dhënave nr. 08-98 të datës 01.11.2023 të Komisionit në afatin e përcaktuar, e në kuptim të nenit 49 të Ligjit, në mënyrë që nuk i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara me konkluzionin e theksuar në afatin e përcaktuar, i cili skadonte më 17.11.2023, si ditë deri kur EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup ishte e detyruar t'i dorëzonte të dhënat e kërkuara dhe me këtë ka kryer kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, për çka i shqiptohet sanksion – gjobë në shumën prej 60.000,00 denarë, që paraqet 0,03338% të vlerës së të ardhurave të përgjithshme vjetore të EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup të realizuara në vitin 2024, si viti i fundit afarist për të cilin e njëjta ka përpiluar llogari vjetore.

2. Gjobën nga pika 1) të këtij vendimi kryerësit e kundërvajtjes janë të detyruar ta paguajnë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit në llogarinë e transaksionit të marrësit të pagesës: 100-0000000630-95, llogaria e pagesës: 840xxx07337 - gjoba për kundërvajtje të kryera nga fusha në kompetencë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me shifrën e të hyrave 722139 dhe programi 00, marrësit të pagesës - Ministria e Financave, banka e pranuesit – BPRMV, dhe Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës t'i dorëzojnë dëshmi/kopje të pagesës së kryer të gjobës në afat prej 15 ditësh nga pagesa e kryer. Gjoba e papaguar ose gjoba e paguar me vonesë do të arkëtohet në rrugë të detyrueshme. Padia e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me shkresën nr. 08-21 të datës 15.04.2024 te Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dorëzoi kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje.

Me kërkesën, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës kërkon që Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të fillojë procedurë sipas detyrës zyrtare, ndër të tjera edhe ndaj Shoqërisë për grumbullim dhe përpunim

primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup, me seli në rr. "Gjorgji Kolozov" nr. 10, Gazi Babë, me NUAS: 5124514 dhe numër unik tatimor: 4030996203809 e përfaqësuar nga Vllado Momirovski - drejtues, për shkak të mosveprimit sipas konkluzionit nr. 08-98 të datës 01.11.2023 për dorëzimin e të dhënave në afatin e përcaktuar, e në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, që paraqet kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Më tej në kërkesë thuhet se Shoqëria për grumbullim dhe përpunim primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk i ka dorëzuar të dhënat e nevojshme, në afatin ligjor të përcaktuar prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të konkluzionit nr. 08-98 të datës 01.11.2023, respektivisht nuk ka dorëzuar: Sasinë e përgjithshme të blerë të letrës mbeturinë nga persona fizikë (mbledhës joformalë) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasinë e përgjithshme të blerë/grumbulluar të letrës mbeturinë nga subjekte juridike (krijues të mbeturinave) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasinë e përgjithshme të blerë/grumbulluar të letrës mbeturinë nga subjekte të tjera (të ceket cilat) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasinë e përgjithshme të blerë të plastikës mbeturinë nga persona fizikë (mbledhës joformalë) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasinë e përgjithshme të blerë/grumbulluar të plastikës mbeturinë nga subjekte juridike (krijues të mbeturinave) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasinë e përgjithshme të blerë/grumbulluar të plastikës mbeturinë nga subjekte të tjera (të ceket cilat) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasinë e përgjithshme të blerë të qelqit mbeturinë nga persona fizikë (mbledhës joformalë) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasinë e përgjithshme të blerë/grumbulluar të qelqit mbeturinë nga subjekte juridike (krijues të mbeturinave) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasinë e përgjithshme të blerë/grumbulluar të qelqit mbeturinë nga subjekte të tjera (të ceket cilat) nga territori i qytetit të Shkupit.

Qëllimi i sigurimit të të dhënave ka qenë që Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, si organ kompetent për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25) të kryejë vlerësimin e drejtë të njoftimit të dorëzuar për përqendrim ndërmjet KAPPA STAR RECYCLING DOO, Umka Serbi dhe NUTRIVET SHPK Shkup, të cilat kanë pasur ndërmend të kryejnë bashkimin e biznesit për grumbullim, transport, magazinim dhe trajtim të mbeturinave të parrezikshme të NUTRIVET SHPK Shkup me biznesin e EKO STAR RECIKLAZHA SHPKNJP Shkup.

Duke pasur parasysh faktin se Shoqëria për grumbullim dhe përpunim primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup konkluzionin nr. 08-98 të datës 01.11.2023 e ka pranuar më 07.11.2023 dhe nuk ka vepruar sipas konkluzionit, respektivisht nuk i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara, në afatin e përcaktuar, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës kërkon që Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje si organ i cili udhëheq procedurën për kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe shqipton sanksion për kundërvajtje për kundërvajtjet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, sipas detyrës zyrtare të fillojë procedurë për kundërvajtje kundër SHGPPMEI EKOCENTAR 97 Shkup, për shkak të vërtetimit të kundërvajtjes eventuale nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Duke e pasur parasysh këtë që u theksua më lart, e për arsye se Shoqëria për grumbullim dhe përpunim primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup nuk ka vepruar në afatin ligjor të përcaktuar për përgjigje sipas Konkluzionit 08-98 të datës 01.11.2023, KVK pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në seancën e mbajtur në

ditën 21.02.2025, solli Konkluzion për fillimin e procedurës për kundërvajtje PK nr. 09-37/1, me të cilin Konkluzion, KVK kërkoi që Shoqëria për grumbullim dhe përpunim primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup t'i dorëzojë te KVK dokumentet dhe të dhënat në vijim: Certifikatë nga Regjistri Qendror për gjendjen aktuale; Bilancin e suksesit për vitin 2023 dhe Të dhëna për xhiro-llogarinë, numrin unik tatimor dhe deponentin – bankën në afat prej 8 ditësh.

Konkluzioni është dorëzuar me shkresë përcjellëse PK nr. 09-37/2 të datës 21.02.2025.

Në ditën 06.03.2025 Shoqëria për grumbullim dhe përpunim primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup dorëzoi përgjigje ndaj Konkluzionit për fillimin e procedurës për kundërvajtje PK nr. 09-37/3 dhe me të njëjtin i dorëzoi të dhënat dhe dokumentet e kërkuara.

Gjithashtu duam të theksojmë se Shoqëria për grumbullim dhe përpunim primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup në shtojcë të përgjigjes së Konkluzionit i dorëzoi edhe të dhënat e kërkuara nga ana e Komisionit me Konkluzionin për dorëzimin e të dhënave dhe dokumenteve nr. 08-98 të datës 01.11.2023.

Në ditën 04.04.2025 Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës solli Njoftim paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-37/4.

Njoftimi paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-37/4 është dorëzuar me shkresë përcjellëse PK nr. 09-37/5.

Në ditën 17.04.2025 EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup dorëzoi përgjigje të EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup PK nr. 09-37/6.

Në përgjigje thuhet se shoqëria nuk ka vepruar sipas Konkluzionit nr. 08-98 të datës 01.11.2023 sepse i njëjti nuk ka arritur te menaxhmenti i EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup. Pas pranimit të Konkluzionit për fillimin e procedurës për kundërvajtje PK nr. 09-37/1 të datës 21.02.2025, EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup ka vepruar sipas të njëjtit dhe i ka dorëzuar te Komisioni të gjitha dokumentet dhe të dhënat e nevojshme. Në deklarimin e tij EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup thekson se pajtohet plotësisht me pretendimet e paraqitura në Njoftimin paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar dhe e lut Komisionin që e njëjta t'i marrë parasysh rrethanat për mosveprimin e paqëllimshëm sipas Konkluzionit të Komisionit edhe gjatë shqiptimit të gjobës nga ana e Komisionit.

Në ditën 30.05.2025 KVK solli Njoftim përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-37/7.

Njoftimi përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar i është dorëzuar Shoqërisë për grumbullim dhe përpunim primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup me shkresë përcjellëse PK nr. 09-37/8.

Shoqëria për grumbullim dhe përpunim primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup nuk dorëzoi te KVK deklarim lidhur me Njoftimin përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar.

Pas sigurimit të të dhënave të nevojshme me rëndësi për vendimmarrje të drejtë në procedurën për kundërvajtje dhe nga dëshmitë e mbledhura në vendin e ngjarjes, si dhe nga deklarimi pas njoftimit paraprak dhe përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar të Shoqërisë për grumbullim dhe përpunim primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup, KVK konstatoi se:

Shoqëria për grumbullim dhe përpunim primar të mbeturinave eksport-import EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup nuk ka vepruar sipas Konkluzionit për dorëzimin e të dhënave nr. 08-98 të datës 01.11.2023 të Komisionit në afatin e përcaktuar, e në kuptim të nenit 49 të Ligjit, në mënyrë që nuk i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara me konkluzionin e theksuar në afatin e përcaktuar i cili skadonte më 17.11.2023, si ditë deri kur EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup ishte e detyruar t'i dorëzonte të dhënat e kërkuara dhe me këtë ka kryer **kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

Në pajtim me nenin 61 paragrafi (1) të LMK-së, KVK ndërmarrjes, respektivisht shoqatës së ndërmarrjeve, me vendim do t'i shqiptojë gjobë në shumë deri në 1% të vlerës së të ardhurave të përgjithshme vjetore të realizuara në vitin e fundit afarist, e shprehur në vlerë absolute dhe nominale për të cilën ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve ka përpiluar llogari vjetore nëse:

-Nuk vepron sipas konkluzionit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës ose Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje për dorëzimin e të dhënave në afatin e përcaktuar, e në kuptim të nenit 40, nenit 48 dhe nenit 49 të këtij ligji.

Të ardhurat e përgjithshme të EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup të realizuara në vitin 2024 arrijnë në 179.744.730,00 denarë.

KVK konstatoi se shuma e gjobës e cila i shqiptohet EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup për kundërvajtjen e kryer nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës arrin në 60.000,00 denarë, që paraqet 0,03338% të vlerës së të ardhurave të përgjithshme vjetore të EKOCENTAR 97 SHPKNJP Shkup të realizuara në vitin 2024, si viti i fundit afarist për të cilin e njëjta ka përpiluar llogari vjetore.

Për shkak të të gjitha atyre që u theksuan më lart u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi. Padia e shtyn ekzekutimin e vendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KOMISIONI PËR VENDIMMARRJE PËR KUNDËRVAJTJTE
KRYETAR
Mr. Борче Размоски**